



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1798/3 Prot.

Tiranë, më 28.12.2017

VENDIM

Nr.242, datë 28.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 84, DATË 18.04.2017,
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË BELSH**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 84, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017”, në institucionin e Bashkisë Belsh.

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.105, datë 26.09.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Belsh, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 26.04.2016 e në vazhdim”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit në Bashkinë Belsh, prej datës 26.04.2016, e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 84, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Belsh, që për rregullimin e ligjshmërisë, të anulojë aktin e emërimit nr. 202, datë 20.05.2016, që ka dalë në kundërshtim me ligjin, për punonjësin *****, në pozicionin e punës, “Specialist Kadastrë”, në Sektorin e Kadastrës, Topografisë dhe Rregjistrimit.

2. Pozicioni i punës, “Specialist Kadastrë”, në Sektorin e Kadastrës, Topografisë dhe Rregjistrimit, duhet të plotësohet me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo dhe nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele.

3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Belsh, të zbatojë vendimin brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Nr. 84, datë 18.04.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017”*, me Vendimin Nr. 229, datë 09.11.2017, *“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 84, datë 18.04.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017’”*, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 84, datë 18.04.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Joni Marko dhe Migena Haznedari, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 17.11.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Belsh.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Belsh dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1798/2 prot., datë 09.11.2017, *“Njoftim për fillimin e verifikimit”*.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 17.11.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personi i kontaktit të institucionit të Bashkisë Belsh (Drejtori i Burimeve Njerëzore).

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikat 1 dhe 2 të vendimit, Komisioneri i ka lënë detyrë Kryetarit të Bashkisë dhe njësisë përgjegjëse të institucionit, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me emërimin në kundërshtim me ligjin për punonjësin *****, në pozicionin *“Specialist Kadastrë”*, të anulojë aktin e emërimit, duke e shpallur të lirë pozicionin e mbajtur prej tij dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, në përputhje me nenet 22, 23 e vijues të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Me Urdhrin Nr. 67, datë 31.03.2017, pika 2 e tij, Kryetari i Bashkisë Belsh ka urdhëruar shfuqizimin e Urdhrit nr. 202, datë 20.05.2016, për emërimin e punonjësit *****, në pozicionin “*Specialist Kadastrë*”, si akt i dalë në kundërshtim me ligjin.

Nga verifikimi në subjekt, rezultoi se Kryetari i Bashkisë Belsh me Urdhrin nr. 62 prot., datë 29.03.2017, pika a, ka ndryshuar strukturën organizative. Sipas këtij Urdhri, një pozicion “*Specialist Kadastrë*”, në Drejtorinë e Menaxhimeve Bujqësore, Veterinare, në Sektorin e Kadastrës, Topografisë dhe Regjistrimit është nxjerrë jashtë shërbimit civil (*duke ndryshuar edhe emërtesë në “Teknik Kadastrë”; punonjësi i emëruar në këtë pozicion kryen detyra të karakterit teknik, sikundër grupi i punës u informua nga përfaqësuesi i burimeve njerëzore të institucionit*).

Për sa u parashtua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 84, datë 18.04.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017*”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit Bashkia Belsh janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna nga Komisioneri.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 84, datë 18.04.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017*”, në Bashkinë Belsh.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Belsh, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 84, datë 18.04.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Belsh dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha